

V E N D I M
Nr.529, datë 16.11.1999

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.357, DATË 28.7.1999, "PËR PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA, NË VITIN
SHKOLLOR 1999-2000 NË SISTEMIN ME SHKËPUTJE NGA PUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.357, datë 28.7 1999, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3 paragrafi i fundit, fjalët "kuotat për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës....20", ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët "kuotat për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës....50".

2. Në pikën 14 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Vendet e paplotësuara nga të gjitha kategoritë e kuotave të pranimeve të reja, të përcaktuara në këtë vendim, të administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës".

3. Pas pikës 14, shtohet pika 14.1 me këtë përmbajtje:

"Shtohen 17 kuota në degët, ku konkurruesit kanë fituar, por për arye të justifikuara nuk janë regjistruar".

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta